

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RETAIL PARK SH.P.K.
ME SELI NË : "RRUGA LUIGJ GURAKUQI, PALLATI 89, SHK.1, AP.33, TIRANË, SHQIPËRI
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
L71515042Q

VENDIMI

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 29.10.2020, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë "**Retail Park**" Sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në "Rruga Luigj Gurakuqi, pallati 89, shk.1, ap.33, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**")", mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

1. "**Balfin**" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("**Ortaku i Vetëm**").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Itena Ndroqi, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

- I. **MIRATIMI I DORËHEQJES SË Z. KLENTI BUDINA NGA DETYRA E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË DHE EMËRIMI I Z. ENIS RADA NË DETYRËN E ADMINISTRATORIT TË RI TË SHOQËRISË;**
- II. **ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRINË RETAIL PARK SH.P.K.**

- I. **MIRATIMI I DORËHEQJES SË Z. KLENTI BUDINA NGA DETYRA E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË DHE EMËRIMI I Z. ENIS RADA NË DETYRËN E ADMINISTRATORIT TË RI TË SHOQËRISË;**

Në lidhje me pikën e parë në Rend të ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se, administratori i Shoqërisë Z. Klenti Budina ka paraqitur dorëheqjen nga ky pozicion për arsye personale, dorëheqja e cila është kërkuar duke nisur nga data 30.10.2020.

Përsa me sipër, propozohet pranimi i dorëheqjes së Z. Klenti Budina nga detyra e Administratorit të Shoqërisë dhe emërimi i Z. Enis Rada, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 07.08.1079, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. BD1154760 dhe me numër personal H90807172T si Administrator i ri i Shoqërisë.



Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë dorëheqjen e Z. Klenti Budina nga pozicioni i Administratorit të Shoqërisë duke nisur nga data 30.10. 2020.
- B. Të miratojë, Z. Enis Rada, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 07.08.1079, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. BD1154760 dhe me numër personal H90807172T si Administrator i ri i Shoqërisë;
- C. Të miratojë mandatin e Administratorit të ri të Shoqërisë për 3 vitet e ardhshme duke filluar nga data 30.10.2020 deri më 30.10.2023.

Të autorizojë z. Enis Rada, administrator i shoqërisë Retail Park sh.p.k., të kryejë çdo veprim të nevojshëm për regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit si edhe të autorizojë persona të tretë për këtë qëllim.

D.

II. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRINË RETAIL PARK SH.P.K.

Duke kaluar në diskutimin e çështjes së dytë të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se:Ortaku i Vetëm zotëron 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë i cili është aktualisht 100 LEK (një qind lekë). Me qëllim shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë ndaj të tretëve dhe injektimin e nje kapitali operacional në të, Administratori i ri i Shoqërisë sugjeron zmadhimi e kapitalit të saj me 1,500,000 LEK (një milion e pesë qind mijë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:


VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q) me LEK 1,500,000 LEK (një milion e pesë qind mijë lekë);
- B. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 100 LEK (një qind leke) bëhet 1,500,100 LEK (një milion e pesë qind mijë e një qind lekë);
- C. Të autorizojë përdorimin e kapitalit të injektuar për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë ndaj të tretëve, si dhe për përmbushjen e nevojave operationale të Shoqërisë.

III. TË NDRYSHME

Në lidhje me piken e tretë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se vendimet e mara në këtë mbledhje Asambleje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në Qendrën Kombare të Biznesit dhe për këtë qëllim

VENDOS:



Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
RETAIL PARK SH.P.K.**


KRYETAR /ORTAK I VETËM



ZNJ. EDLIRA MUKA



SEKRETAR



ZNJ. JENA NDRIQI